Raport i Vleresimi te Ndikimit ne Mjedis

Aktiviteti: Sherbimi Shendetesore

SPITALI RAJONAL DIBER

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

u Hartua nga Studio "REAL -P "sh.p.k.

Peshkopi Prill 2017

1. Te dhena te pergjithshme

Spitali Rajonal Qarkut Diber ndodhet ne qender te qytetit te Peshkopise dhe kryen nje funksion te rendesishem,si pjese e sistemit shendetesor,ne sherbim te popullates se ketij rajoni.

Ne kryerjen sa me mire te ketij funksioni te rendesishem ne permiresimin e gjendjes shendetesore te popullates se ketij rajoni,spitali i Peshkopise ka per synim permiresimin e vazhdueshem te punes e kujdesit shendetesor nepermjet hartimit te politikave, strategjive dhe menaxhimit direkt te sherbimeve shendetesore.

Ne punen e ketij institucioni vihet re nje permiresim i vazhdueshem i sherbimit per t'u rikthyer qytetarëve besimin e humbur tek shërbimi shëndetësor, t'u japim atyre mbrojtjen e merituar përmes një sistemi shëndetësor me mbulim universal dhe t'u krijojmë profesionistëve kushtet e nevojshme për të shërbyer me cilësi.

Spitali rajonal Peshkopi gjendet i perqendruar ne tre godina ku kurohen te semure jo vetem nga qyteti i Peshkopise por edhe nga komunat rreth e rrotull. Numri i shtreterve eshte 295 gjithsej. Ne qytet sipas lagjeve ndodhen edhe 5 qendra shendetesore. Numri i mjekeve qe sherbejne ne keto qendra shendetesore eshte 6 dhe numri i infermiereve eshte 31. Te gjitha qendrat shendetesore jane ndertuar te reja gjate viteve 2002 – 2005.

Per spitalin e Peshkopise qe sherben si qender kurimi edhe per te gjithe fshatrat e rrethit te Dibres, ne saje te investimeve te bera jane permiresuar ndjeshem ambientet dhe pajisja e spitalit me mjetet e nevojshme.

Në Dibër aktualisht operojnë në nivel komuniteti 162 qendra mjekësore pa shtretër (1poliklinikë, 15 qendra shëndetësore dhe 146 ambulanca, 1 spital rajonal, 15 konsultore të nënës,15 konsultore për fëmijë dhe 15 farmaci dhe 11 klinika dentare private). Spitali rajonal ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri,reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Spitali ka një kapacitet prej 270 shtretërish. Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 24 mjekë specialistë, 222 staf mjekësor (infermierë) dhe 137 punonjës administrate. Struktura gjinore e stafit spitalor është 84% femra,ndërkohë që femrat përbëjnë vetëm 33% të mjekëve specialistë. Shërbimi spitalor është i përqendruar në tri godina, ku kurohen, jo vetëm pacientë nga bashkia, por dhe nga të gjitha njësitë administrative të rrethit të Dibrës.

Disa te dhena per spitalin jane paraqitur ne tabelen e meposhtme.

Kategoria	Total	Femra	Meshkuj	Arsim i larte	Arsim i mesem
Mjeke	24	10	14	24	-
Infermiere	195	188	7	-	195
Laborante	20	13	7	-	20

Megjithe ndryshimet e bera gjate viteve te fundit ne rikonstruksionin e godinave dhe ne pajisjen e spitalit me mjetet perkatese nje problem kryesor qe ndikon ne cilesise e sherbimit shendetsor eshte largimi i mjekeve dhe mungesa e specialisteve ne disa specialitete. Ky fakt ben qe shume paciente te shkojne per kurim dhe per vizita mjekesore ne spitalet e Tiranes.Tranzicioni , i vështirë ne vendin tone ,ashtu si edhe ne gjithe Shqiperine,ka lënë gjurmë edhe në sistemin shëndetësor në Dibër. Treguesi në ulje i jetëgjatësisë mesatare, nga 72 në 70.5 vjeç, niveli i lartë në përgjithësi i mortalitetit, niveli i lartë i mortalitetit mëmësor, i theksuar ky në zonat rurale, të gjithë këta janë tregues të një gjendjeje jo shumë të kënaqshme.
Qendrat mjekësore pa shtretër u bënë objekte të shkatërrimit dhe zaptimit, kryesisht në zonën e fshatrave. Me institucionet spitalore dhe ato të shërbimit parësor ka gjithmonë probleme, që lidhen me pronësinë e tokës. Sot zona e Dibrës ka edhe numrin më të vogël të qendrave shëndetësore për çdo 10,000 banorë dhe gjendja në këto qendra nuk është e kënaqshme.
Mungesa e infrastrukturës, që lidhet me rrugët, si dhe me mjetet, çon në rritjen e rasteve të urgjencave të patrajtuara nga personeli i kualifikuar

Ne kete peiudhe te tranzicionit dhe kryesisht pas vitit 2002,jane bere vazhdimisht rikonstruksione ne spitalin e Peshkopise dhe reparte te vecanta per te permiresuar sherbimin mjeksor ne trajtimin e semundjeve e ndryshme.

Ne kuader te permiresimit te punes,ne sherbim tc qytetareve,gjate vitit 2016,u perurua kabineti i ri i Kardiollogjise në kete Spital , nepermjet një investim 5.8 milionë lekësh nga Qeveria, pjesë angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë për përmirësimin shëndetësor në çdo skaj i vendit









Vendndodhja e objektit te Spitalit Rajonal Diber.

Spitali Rajonal Diber ndodhet ne nje siperfaqja e toke prej 6325m^2 , ku jane ndertuar sipas nje projekti te detajuar nga specialist te fushes se urbanistikes, te gjitha repartet e sherbimit shendetesor dhe ambiente te tjera , ne sherbim dhe funksion te ketij institucioni te rendesishem, ne sherbim te qytetareve dhe komunitetit te rajonit te Qarkut Diber.

Kjo siperfaqe toke per qytetin e Peshkopise , ndodhet ne nje pjese periferike dhe ate veriore te ketij qyteti , vend shume i favorshem dhe i pershtatshem per funksionin normal te ketij institucioni. Spitali rajonal Peshkopi gjendet i perqendruar ne tre godina , te ndertuara sipas nje projekti te pershtatshem per nje funsionim sa me normal,ku kurohen te semure jo vetem nga qyteti i Peshkopise por edhe nga komunat rreth e rrotull. Spitali rajonal ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri , reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Spitali ka një kapacitet prej 270 shtretërish.



Spitali Rajonal Peshkopi

Kjo siperfaqe toke eshte prone publike dhe nuk ndonje status te vecante mbrojtjeje, qe ploteson te gjitha kushtet e duhura e te nevojeshme per tu shfrytezuar per qellimin e funksionin e tij.

Objekti dhe siperfaqja e tokes ku eshte ndertuar objekti i ketij spitali, eshte i rrethuar dhe ne te mbizoteron nje mjedis I gjelberuar dhe i pershtatshem per nje funksionim normal te sherbimeve shendetesore.

Rreth ketij objekti dhe jashte rrethimit te tij ekzistojne disa lokale tregetare sherbimi si dhe disa banesa te pronareve te tokes,te cilet nuk ndikojne dhe nuk ndikohen nga sherbimet shendetesore te kryera nga ky institucion.

Siperfaqja e zones se kerkuar per leje mjedisore eshte_____

-Kordinatat

Pershkrimi i sherbimeve te kryera nga Spitali Peshkopi

Spitali rajonal Peshkopi gjendet i perqendruar ne tre godina ku kurohen te semure jo vetem nga qyteti i Peshkopise por edhe nga komunat rreth e rrotull. Numri i shtreterve eshte 295 gjithsej. Ne qytet sipas lagjeve ndodhen edhe 5 qendra shendetesore. Numri i mjekeve qe sherbejne ne keto qendra shendetesore eshte 6 dhe numri i infermiereve eshte 31. Te gjitha qendrat shendetesore jane ndertuar te reja gjate viteve 2002 – 2005.

Per spitalin e Peshkopise qe sherben si qender kurimi edhe per te gjithe fshatrat e rrethit te Dibres, ne saje te investimeve te bera jane permiresuar ndjeshem ambientet dhe pajisja e spitalit me mjetet e nevojshme.

Në Dibër aktualisht operojnë në nivel komuniteti 162 qendra mjekësore pa shtretër(1poliklinikë, 15 qendra shëndetësore dhe 146 ambulanca, 1 spital rajonal, 15 konsultore të nënës,15 konsultore për fëmijë dhe 15 farmaci dhe 11 klinika dentare, private). Spitali rajonal ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri,reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Spitali ka një kapacitet prej 270 shtretërish. Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 24 mjekë specialistë, 222 staf mjekësor (infermierë) dhe 137 punonjës administrate. Struktura gjinore e stafit spitalor është 84% femra, ndërkohë që femrat përbëjnë vetëm 33% të mjekëve specialistë. Shërbimi spitalor është i përqendruar në tri godina, ku kurohen, jo vetëm pacientë nga bashkia, por dhe nga të gjitha njësitë administrative të rrethit të Dibrës. Tranzicioni , i vështirë ne vendin tone , ashtu si edhe ne gjithe Shqiperine, ka lënë gjurmë edhe në sistemin shëndetësor në Dibër. Treguesi në ulje i jetëgjatësisë mesatare, nga 72 në 70.5 vjeç, niveli i lartë në përgjithësi i mortalitetit, niveli i lartë i mortalitetit mëmësor, i theksuar ky në zonat rurale, të gjithë këta janë tregues të një gjendjeje jo shumë të kënaqshme.

Qendrat mjekësore pa shtretër u bënë objekte të shkatërrimit dhe zaptimit, kryesisht në zonën e fshatrave. Me institucionet spitalore dhe ato të shërbimit parësor ka gjithmonë probleme, që lidhen me pronësinë e tokës. Sot zona e Dibrës ka edhe numrin më të vogël të qendrave shëndetësore për çdo 10,000 banorë dhe gjendja në këto qendra nuk është e kënaqshme. Mungesa e infrastrukturës, që lidhet me rrugët, si dhe me mjetet, çon në rritjen e rasteve të urgjencave të patrajtuara nga personeli i kualifikuar

Ne kete peiudhe te tranzicionit dhe kryesisht pas vitit 2002,jane bere vazhdimisht rikonstruksione ne spitalin e Peshkopise dhe reparte te vecanta per te permiresuar sherbimin mjeksor ne trajtimin e semundjeve e ndryshme.

Ushtrimi i ketyre sherbimeve mjeksore ndaj ketij komuniteti, ne spitalin e Peshkopise,ashtu si edhe ne qendrat shendetesore te ketij rajoni, padyshim qe prodhohen ose mbeten gjate punes e proceseve te ndryshme shume mbetje, ku nje pjese e tyre ka nje rrezikshmeri te larte ne ndotjen e mjedisit dhe kryesisht ne shendetin e njeriut.

Per te eliminuar dhe reduktuar efektet negative te mbetjeve te rrezikeshme,ne kete spital, ashtu si edhe ne nje pjese te mire te qendrave shendetesore, kziston nje rregullore e brendshme për trajtimin dhe menaxhimin e ketyre mbetjeve spitalore.

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti ne sherbimin ndaj qytetareve te ketij komuniteti, per vete llojin e sherbimeve, ashtu si ne te gjithe vendin, natyra e ketyre mbetjeve eshte e shumellojeshme dhe ato kane efekte te ndryshme e te rrezikshme per ndotjen e mjedisit dhe ndikojne shume ne shendetin e njeriut.

Prodhues i mbetjes spitalore jane personat fizik dhe juridik, te cilit zotërojnc ose administrojne një institucion shëndetësor, që krijon mbetje spitalore, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar vetëm në spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, laborator dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore-shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare, shërbimet ambulatore të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

Ne spitalet dhe qendrat shendetesore, nga sherbimet dhe disa procese pune, sipas natyres e prejardhjes, gjenerohen , krahas mbetjeve te ngurta e urbane, jo te rrezikshme si dhe disa lloje mbetjesh te rrezikshme spitalore

Nga shuma e përgjithshme e mbeturinave të gjeneruara nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor, rreth 80% e tyre është mbetje e përgjithshme, 20% e mbetur konsiderohet material i rrezikshëm që mund të jetë infektiv, toksik apo radioaktiv.
Mbetje spitalore e rrezikshme përfshin mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar.

Mbetje spitalore e pa rrezikshme përfshin letrat, sendet prej qelqi, plastike, kartonët, ambalazhet, mbeturinat ushqimore, mbeturina druri dhe ndërtimi. Mbetje te rrezikshme mjekësore përkufizohen mbetjet e gjeneruar si rezultat i diagnostikimit, trajtimit, dhe imunizimit të njerëzve apo kafshëve. Keto mbeturina te prodhuara janë rezultat i hulumtimit biomjekësor dhe i prodhimit dhe testimit të organizmave, qelizave dhe njësive të tjera biologjike.

Si mbetje spitalore te rrezikshme jane edhe ato farmaceutike ku perfshihen produktet farmaceutike të skaduara ose të pa përdorshme, produktet farmaceutike të kontaminuara nga rënia ose hedhja përtokë, barnat e tepërta, vaksinat ose serumet dhe sendet e hedhura të përdorura gjatë trajtimit të barnave, të tilla si: shishe, kuti, doreza, maska, tuba etj.

Keto mbetje qe gjenerojne gjate sherbimit e kujdesit shëndetësor, përmbajnë mikroorganizma potencialisht të dëmshme të cilat mund të infektojnë pacientët në spital, punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe publikun e gjerë.

Sipas prejardhjes dhe natyres se tyre ato jane te shumellojeshme dhe ndikimi i tyre eshte i ndryshem ne perhapjen e shume semundjeve tek njerezit dhe kafshet. Nga hulumtimet e kryera ne bote eshte arritur ne perfundime se, nga mostrajtimi i ketyre mbetjeve sipas rregullave dhe kritereve te percaktuara,perhapen semundje te rrezikshme infektive te shkaktuara nga virusi i hepatitit B (HBV) , virusi i hepatitit C, virusi i perhapjes HIV etj. Keto rreziqe dhe perhapja e ketyre semundjeve,jane evidente dhe te mundeshme nga hedhja e ketyre mbeturinave ne vende te papershtateshme e mostrajtimi i tyre sipas kritereve te percaktuara,djegia e mbeturinave spitalore,hedhja e tyre ne lumenje vende te tjera publike. Si rezultat i ketij mosvleresimi te ketij problem mund te shkaktohet nje ndotje me pasoja per

shendetin e njeriut dhe kafsheve nga perhapja e viruseve dhe helmimet nepermjet produkteve farmaceutike e ne vecanti nga antibiotiket dhe barna te vecanta,helmimet dhe ndotja permes ujrave te zeza, helmimet dhe ndotja nga elemente toksike ose komponime si merkuri ose dioksina qe shperndahen ne ajer gjate procesit te trajtimit apo asgjesimit te tyre. Te tilla rreziqe ndodhin edhe nga të ushqyerit e bagëtive me mbeturina në vendgrumbullimet e mbetjeve, sidomos ne fshatra,ne rastet kur keto mbeturinave të rrezikshme hidhen ne vende te hapura. Mbetjet infektive dhe anatomike përfaqësojnë shumicën e mbetjeve të rrezikshme, deri në 15% të totalit të mbetjeve nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor. Shiringat dhe aget përfaqësojnë rreth 1% të totalit të mbetjeve, por ato janë një burim kryesor i transmetimit të sëmundjes, nëse nuk menaxhohen si duhet. Substancat kimike dhe farmaceutike përbëjnë rreth 3% të mbetjeve nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor, dhe 1% e përbëjnë substancat radioaktive të totalit të mbetjeve të kujdesit shëndetësor.

Duke u nisur nga keto fakte dhe pasojat e medha qe vijne nga mostrajtimi i ketyre mbeturinave te rrezikshme e me pasoja te medha per mjedisin dhe shendetin e njerezve,e rendesishme eshte trajtimi dhe kujdesi i madh qe duhet te tregohet per klasifikimin, ndarjen e tyre,duke zbatuar te gjitha udhezimet dhe kriteret e percaktuara ne dispozitat ligjore ; Ligjit Nr. 10431, dt. 09. 06. 2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" ,Ligjit Nr.10463 dt 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve ,Ligjit nr. 9537, dt. 18. 5. 2006 " Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" , VKM nr.798, datë 29. 09. 2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore" ,Ligjit nr.9323, datë 25. 11. 2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik",Ligjit nr. 10, datë 11. 05. 2009 "Për shëndetin publik".

Ne zbatim te ketyre udhezime, edhe ne institucionin shendetesor te spitalit rajonal Diber dhe qendrave shendetesore te njesive administrative, kohet e fundit, eshte vene re nje perkujdesje me e mire ne administrimin e ketyre mbetjeve. Megjithate kjo pune e nisur duhet te shtrihet ne te gjithe pavionet dhe ambientet e spitalit e sidomos ne qendrat shendetesore te ketij rrethi.

Sasia e gjeneruar e mbetjeve spitalore sipas qendrave shendetesore eshte:

Nr	QENDRA SHENDETESORE	Sasia e Mbetjeve	Gjithsej Sasia e mbetjeve
1	Fushe-Cidhen	10 kg/muaj	10 kgx 12 muaj =120kg/vit
2	Sllove	8kg/muaj	8 kg x 12 muaj = 96 kg/vit

3	Kala e Dodes	5 kg/muaj	5 kg x 12 muaj = 60 kg/vit
4	Lure	10 kg/muaj	10 kg x 12 muaj =120 kg/vit
5	Luzni	12 kg/muaj	12 kg x 12 muaj =144 kg/vit
6	Selishte	10 kg/muaj	10 kg x 12 muaj =120kg/vit
7	Kastriot	14 kg/muaj	14 kg x 12 muaj =168kg/vit
8	Muhurr	12 kg/muaj	12 kg x 12 muaj =120kg/vit
9	Tomin	10 kg/muaj	10 kg x 12 muaj =120kg/vit
10	Zall - Dardhe	8 kg/muaj	8 kg x 12 muaj = 96 kg/vit
11	Zall - Rec	5 kg/muaj	5 kg x 12 muaj = 60 kg/vit
12	Arras	10 kg/muaj	10 kg x 12 muaj =120kg/vit
13	Melan	10 kg/muaj	10 kg x 12 muaj =120kg/vit
14	Maqellare	15 kg/muaj	15 kg x 12 muaj =180kg/vit
15	5 Q .Shendet Qytet	25 kg/muaj	25 kg x 12 muaj =180kg/vit
	SHUMA	**179 kg /muaj**	**179kg x 12 muaj=2148 kg**

Spitali Rajonal i Peshkopise,ne ushtrimin e funksionit te tij ne sherbimin shendetesor ndaj komunitetit te ketij rajoni, e ne zbatim te dispozitave te lartepermendura, ne pergjithesi, tregon nje kujdes te mire ne trajtimin , ndarjen dhe grumbullimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore.,sipas VKM nr.798, datë 29. 09. 2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore".



Per kete qellim, nga ana e ketij institucioni , eshte lidhur nje kontrate me nje subjekt te licensuar per pastrimin e mbetjeve spitalore te gjeneruar (MEDI-TEL). Ne kete spital, ne zbatim te dispozitave ligjore qe kane te bejne me mireadministrmin e mbetjeve spitalore, ne pergjithesi, kryhet klasifikimi i mbetjeve ne burim(VKM nr.798, datë 29. 09. 2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore"). Duhet te theksohet se,edhe pse ka filluar nje pune e mire per trajtimin dhe administrimin e ketyre mbetjeve, ne pavionet e ketij spitali, nuk rregjistra te rregullta per sasine e mbetjeve te gjeneruara. Sasia e gjeneruar e mbetjeve spitalore eshte **179** kg per nje muaj dhe ne vit kjo sasi shkon deri **2148 kg.**

Te dhena mbi mjedisin dhe infrastrukturen e zones

Gjeografia e zones. Te dhena te pergjitheshme

Bashkia Peshkopia, ne teritorin e se ciles ndodhet edhe Spitali Rajonal Diber,shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe është qyteti më i populluar në qarkut të Dibrës. Qyteti i Peshkopisë është i vendosur ndërmjet koordinatave gjeografike 41° e 53' dhe 20° e 34'.

Bashkia ka si kufij gjeografikë Vargmalet e Deshatit në lindje dhe lumin e Drinit të Zi në perëndim. Ne mes te ketyre dy vargmaleve gjendet lugina e lumit Drini i Zi, me drejtim Jug-lindje, veri-perendim. Lugina e ketij lumi, me thyerje e platforma, valezime dhe thellime me bukuri fantastike, ne dy anet e se ciles gjenden vargje te larta malore, e bejne mjaft interesante relievin e ketij rrethi

Dibra kufizohet në veri me Bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug-perëndim me bashkinë Klos, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Peshkopisë. Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km^2, bashkia e re ka densitet popullsie prej 84.16 banorësh/km^2 sipas Regjistrit Civil dhe 65.70 banorë/km^2 sipas Censusit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra.

Bashkia Peshkopi eshte nje qytet me potenciale zhvillimi ekonomik, social, kulturor, etj. Kjo gje sjell nje perspektive te shkelqyer per rritjen dhe zhvillimin e degeve te tjera te ekonomise. Nentoka e Peshkopise eshte e pasur me minerale te shumte metalore dhe jometalore. Kjo zonë është e pasur me minerale, lende ndërtimi dhe mermerë.

Para viteve 1990, bazë për punësimin e banorëve të qytetit ishin ndërmarrjet shtetërore si Ndërmarrja e Grumbullimit, Fabrika e Sheqernave, Kompostove dhe Pijeve, Fabrika e Bukë-Makaronave, Fabrika e Qumështit, Uzina Mekanike, Parku i Mallrave (i Automjeteve), si dhe Ndërmarrja Bujqësore. Pas viteve '90 këto fabrika dolën jashtë funksionit dhe shumë prej banorëve të qytetit të mbetur të papunë iu drejtuan emigracionit.

Në qytetin e Peshkopisë ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 505 biznese, të cilët janë të përqendruar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të ndryshme, në aktivitet tregtar dhe në prodhim

Klima. Bashkia e Peshkopisë karakterizohet nga një klimë kontinentale mesdhetare me verë të ngrohtë (mbrëmje të freskëta) dhe një dimër të ftohtë që mund të zgjasë nga pesë deri në gjashtë muaj.Megjithatë, relievi malor dhe luginat që ndodhen përreth bëjnë që të formohen mikroklima kryesisht me dimër të ftohtë dhe verë të freskët dhe jo rrallëherë dhe të nxehtë. Sasia mesatare e reshjeve vjetore është 980 mm, kurse temperatura mesatare vjetore është10-12oC. Temperaturat në Bashkinë

Peshkopi luhaten nga minimumi -15°C, kryesisht të shënuara gjatë muajit janar deri në 30°C, në muajt më të nxehtë korrik-gusht.

Relievi i bashkisë së re është përgjithësisht kodrinor dhe malor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Përgjatë 25 viteve të fundit Dibra ka pasur një migrim të brendshëm drejt Tiranës dhe Durrësit si dhe emigrim të konsiderueshëm jashtë vendit.

Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi si dhe me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shtrira në një zonë të thellë. Zona e Dibrës është njëkohësisht edhe krahina e fundit e madhe e Shqipërisë, e cila vijon të përdorë në shkallë të gjerë infrastrukturën rrugore të trashëguar nga koha e komunizmit, pa shumë përmirësime.

Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku ndodhet spitali

Spitali Rajonal Diber është e vendosur në një pjesë te vecuar te ketij qyteti dhe siperfaqja e tokes qe rrethon kete objekt eshte plotesisht e gjelberuar dhe me disa lloje druresh dekorative, si; pishë e zezë, blir, ligustër, shelg lotues etj.
Vete qyteti i Peshkopise është e vendosur në një pjesë shumë të bukur përsa i përket natyrës. Malet që e rrethojnë janë të gjelbër. Qyteti ndahet në mes nga përroi i Llixhave ku në lindje ndodhet lagja Dobrovë dhe në perëndim pjesa tjetër e qytetit. Peshkopia është një qytet i gjelbër me shumë drurë dekorative të kultivuar në hapësirat e gjelbëra të qytetit. Ata janë rreth 1700 copë kryesisht pishë e zezë, bredh, cedër, ligustër, bliri, gështenjë e egër, shelg lotues, panjë fletëfrashër dhe mali, mështekën, gledicie etj.

Peshkopia ka një sipërfaqe prej 191,5 ha nga të cilat 7,3 ha janë parqe dhe lulishte. Megjithatë nuk ka parqe të mirëfillta në të cilat qytetarët mund të pushojnë dhe shëtisin së bashku me familjet e tyre.

Pyjet zene rreth 66% te siperfaqes te siperfaqes se pergjitheshme te qarkut, duke perbere nje potencial te rendesishem mjedisor dhe ekonomik. Ne rrethin e Dibres perfshihen tre zona fitoklimatike nga 4 qe ka Shqiperia, dhe konkretisht: (i)- zonen e

geshtenjes (Castanetum); (ii) zonen e ahut (Fagetum); (iii) zona e hormoqit (Picetum); dhe (iv) zonen e kullotave alpine (Alpinetum)

Ne kuadrin e decentralizimit dhe dhenies se kopetencave pushtet vendore, rreth 60% e fondit pyjor ju jane dhene ne administrim njesive te qeverisjes vendore. Keto pyje perfshijne teritore te cilet ato i kane ne administrim dhe qe po mbeshteten me investime nga projekti i pyjeve i Bankes Boterore, i cili ka si qellim rimekembjen dhe menaxhimin e qendrueshem te tyre.

Relievi dhe klima e favoreshme bejne qe ne kete zone te ndodhen te gjitha katet bimore te vendit tone, duke filluar me shkurret mesdhetare deri ne livadhet alpine. Ne lartesine deri ne 800 m rriten disa lloje dushqesh si bunga, shparthi, qarri, etj., dhe mbi kete lartesi takohet kryesisht ahu (*Fagus silvatica*), pisha e zeze (*Pinus nigra*), rrobulli (*Pinus heldreichi*), bredhi i bardhe (*Abies alba*), arneni (*Pinus peuce*), lajthia (*Corilus coturna*), meshtekna (*Betula pendula*) etj, te cilat pas viteve 90, si rezultat i shfrytezimit pa kriter kana pesuar deme te shumta.

Duhet theksuar se, ushtrimi i sherbimit shendetesor ne spitalin rajonal te qytetit te Peshkopise nuk ka nje ndikim negativ ne te gjithe mbulesen bimore qe rrethon kete institucion,ne se ai zbaton me korektesi dispozitat ligjore dhe kriteret e percaktuara per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme.

Pasurite minerale .Gjeologjia

Rrethi i Dibrës ka një ndërtim te larmishem gjeologjik i cili perbehet nga molasat e plio-kuarternarit, flishiri dhe formacione te tjera magmatik dhe depozitime të kuaternarit. Vendin kryesor e zenë molasat e plio-kuarternarit, por gjejmë edhe rreshpet e paleozoit si dhe gëlqeroret e mesozoit që janë edhe formacionet më të vjetra të vendit tone, kurse shkembenjtë efuzivë dhe flishet ndertojnë skajin me jugor te vargut të Korabit ku gjejmë edhe formacione karbonatike dhe ultra-bazike.

Ndërtimi gjeologjik në këtë rreth mundëson zhvillimin, pasi kjo zonë është e pasur me minerale, lendë ndërtimi dhe mermere. Këto formacione kane bërë që ky rajon te kete pasuri te shumta minerale ku vecojme kromin ne Selishte e Lure, bakrin ne Cerjan e Lure, mermerin ne Muhurr, Arras, Rec, gipsin ne perroin e llixhave, Bahute Vrenjt, Kala e Dodes, hekurin ne stanet e Preshit, Serokol, boksided ne Lure, bojra dheu ne Bllice, Sohodoll, Kabe, Erebare, squfurin ne Kercisht, dhe argjilat ne Kastriot, Kuben dhe Dohoshisht.

Pasurite minerale qe permenden me siper, pergjithesisht jane te pa shfrytezuar, duke perjashtuar objektet e kromit qe shfrytezohen aktualisht dhe ato te mermerit e argjiles te cilat sot nuk shfrytezohen.

Mbetjet urbane

Qe ne fillim nenvizojme se problemi i mbetjeve urbane te qytetit te Peshkopise eshte zgjidhur provizorisht ne vitin 2002. Per caktimin e vend depozites te mbetjeve urbane te qytetit u bashkepunua me SNV-ne dhe nga grandi i qeverise Daneze u investua ne zbatimin e projektit per ndertimin e vend depozitimit te ketyre mbeturinave, ne nje vend te pershtatshem, qe ndodhet ne pjesen Jug-lindore te qytetit, pa rreziqe gjeologjike etj. per nje periudhe mbi 25 vjecare. Ajo c'ka eshte shqetesuese ne kete venddepozite ka te beje me djegjen e mbeturinave duke cliruar gazra te demshme per shendetin e popullates, ne vend qe ate te mbulohen sipas teknologjise se percaktuar.

Per te eliminuar ndotjet e mjedisit , ka ardhur koha per te ndermarre studime te tilla edhe per qendra te tjera me te vogla si Maqellara,Muhurri, Kastrioti, Tomin,Melani etj.

Problematike dhe shqetesim serioz per bashkine Peshkopi ka qene vazhdimisht,grumbullimi i mbeturinave urbane te krijuara si rezultat i ndertimeve te kryera nga qytetaret,investitore e subjekte fizike e juridike qe kane kryer ndertime ne kete qytet. Deri me sot,keto lloj mbeturinash inerte,jane hedhur bashke me mbeturinat urbane ne vendgrumbullimin e tyre,ne pjesen verilindore te qytetit,ne vendin e quajtur "Llasen".

Duke u nisur nga ky problem,Bashkia Peshkopi,kerkon te investoje ne nje vend te pershtatshem dhe pa probleme,per te ndertuar nje vendgrumbullim provizor te mbeturinave inerte,per qytetaret dhe investitoret e kesaj bashkie,te cilet do te paguajne per te gjtha sherbimet e kryera,sipas vendimit te lartecituar te keshillit bashkiak.

Turizmi

Rajoni i Dibres shtrihet ne lindje te Shqiperise ne nje terren te thyer malor pergjithesisht por i kombinuar ne te ashtuquajturen zone e ulet qe fillon nga lumi Drin i zi dhe sa vjen e lartesohet ne pllaja,kodra dhe male te thepisura deri ne kufi me Republiken e Maqedonise.

Vargmalet e Korabit, malit me te larte ne Shqiperi kane nje bukuri te rralle. Ato mbajne mi supe kreshta malesh te perbera nga guri gelqerore dhe formacione gipsi, te veshura me bimesi barishtore te kullotave alpine te llojeve te shumta e qe formojne nje tapet te gjelber ne periudhen pranvere-vere. Lulet e shumta shumengjyreshe, burimet ujore te karaktereve ujvara,liqene natyral,druret pyjor te llojeve fletore dhe halore te cilat vetullojne keto zona alpine shfaqin nje pamje te shkelqyer pejsazhore per banoret vendas dhe vizitoret.

Shume zona te tilla si Kalaja e Dodes me Korabin madheshtor e livadhet alpine, zona e Grames me kullotat alpine, liqenet natyrale te tipit karstik, liqeni artificial ne qender te saj i shoqeruar me druret pyjor te bredhit e pishes jane me te vertete perla te rajonit tone.

Por jo me pas tyre qendron Lura e cila eshte nje perle e tipit alpin me pyje te shumta te llojeve halore,me fshatrat e saj te vendosura ne pllaja e lugina,me shtate liqejt natyral te tipit karstik te cilet jane nje çfaqje e rralle e bukurise.

Fusha e Pelave me nje siprfaqe 50 hektare eshte e rrethuar kudo me bredh e pishe dhe paraqet nje pamje vertet mahnitese ku sipas deshmive te te moshuareve,ne kohe te hershme organizoheshin gara me kuaj gjate periudhes se veres dhe ndaj quhet edhe "Fusha e Pelave". Pamje te tilla shume te bukura mbajne ne vetvete edhe zonat e Ilnices (Hinoska) dhe bjeshka e Pocestit me ujvaren e saj fantastike.

Nje pasuri e rralle qe ka qyteti i Peshkopise, eshte burimi i ujrave termale. Uji eshte me cilesi shume te mire persa i perket kurimit te disa lloj semundejeve. Shume qytetare nga gjithe Dibra, por edhe nga disa rrethe te tjera te vendit, vijne çdo vit ne Peshkopi per te qendruar 10 – 15 dite per te bere banja ne llixhat e Peshkopise. Numri i tyre shkon deri ne 6000, ku midis tyre mbi 500 jane te ardhur nga jashte Shqiperise, kryesisht nga Maqedonia. Ky lloj turizmi, i quajtur turizem kurativ eshte nje mundesi e mire per bashkine dhe vete qytetaret per te rritur te ardhurat lokale.

Nje pasuri e rralle qe ka qyteti i Peshkopise, eshte burimi i ujrave termale. Uji eshte me cilesi shume te mire persa i perket kurimit te disa lloj semundejeve. Shume qytetare nga gjithe Dibra, por edhe nga disa rrethe te tjera te vendit, vijne çdo vit ne Peshkopi per te qendruar 10 – 15 dite per te bere banja ne llixhat e Peshkopise. Numri i tyre shkon deri ne 6000, ku midis tyre mbi 500 jane te ardhur nga jashte Shqiperise,

kryesisht nga Maqedonia. Ky lloj turizmi, i quajtur turizem kurativ eshte nje mundesi e mire per bashkine dhe vete qytetaret per te rritur te ardhurat lokale.

Identifikimi i ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer..

Hidrologjia. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen ku ndodhet spitali i Peshkopise dhe në afërsi të tij

Rrjeti hidrologjik i qytetit te Peshkopise,ku ndodhet edhe spitali rajonal,per te cilin bejme fjale e kete raport, është i dendur dhe karakterizohet nga përrenj të mëdhenj me prurje të përhershme gjithë vjetore dhe më të vegjël apo prroska me prurje të përkohshme në periudhën e rënies së reshjeve dhe të shkrirjes së dëborës. Përroi i Veleshicës është më i madhi me prurje gjatë gjithë periudhës së vitit, që grumbullon ujërat e fushës së Korabit, Sorokolit si edhe të pjesës më të madhe të anës perëndimore të territorit të komunës Kala e Dodës. Pas tij vijnë përroi i Gramës dhe përroi i Bellovës, të cilët kanë prurje gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, përveç këtyre përrenjeve gjenden një numër i madh përrenjesh të tjerë më të vegjël me prurje më të pakta dhe sezonale në kohë reshjesh. Të gjitha prurjet e tyre derdhen në lumin Drin i Zi.

Territori i ketij rrethi është mjaft i pasur në burime ujore të një cilësie të lartë, jo vetëm për plotësimin e nevojave për ujë të pijshëm të banorëve të këtij komuniteti, por edhe të nevojave të blegtorisë që verojnë në bjeshkët e pasura të kësaj zone. Burimi më i madh është ai i Preshit që furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat përgjatë rrugës nga ku ai kalon.

Në këtë territor gjenden disa liqene të natyrës alpino-karstike në përmasa të vogla, pasqyra ujore e të cilëve në brendësi të formacioneve pyjore përfaqëson një mrekulli më vete duke rritur në këtë mënyrë vlerat natyrore të zonës.

Ne teritorin e spitalit te Peshkopise, nuk kalojne ujra netokesore dhe siperfaqesore,te cilat mund te ndikohen nga mbeturinat spitalore qe gjenerohen ne kete institucion. Zbatimi i ketij projekti i spitalit rajonal Diber ne sherbimet shendetesore ndaj komunitetit te ketij rrethi, duke pasur parasysh zbatimin e kritereve te percaktuara ne menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore, ben te mundur qe te mos kete ndonje ndikim ne ujrat siperfaqesore e nentokesore te zones.

Keto mbeturina me rrezikshmeri te larte ne shendetin e njeriut dhe kafsheve, klasifikohen qe ne burim dhe grumbullohen ne vende te vecanta per tu larguar ne nje kohe tjeter nga subjekti i licensuar. Disa nga ndikimet e mundeshme ne ujrat qe dalin nga ky subjekt, te shkaktuara ne se do te hidheshin ne to mbeturinat spitalore, eshte perhapja nepermjet tyre e shume viruseve te semundjeve te rrezikshme per kafshet dhe njerezit

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer ne spitalin rajonal Diber

Ne Spitalin Rajonal Diber ku kryhen nje sere sherbimesh shendetesore ne patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri,reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike, gjenerohen nje sasi e konsiderueshme mbetje te rrezikeshme spitalore,te cilat mund te kene ndikim negative ne ndotjen e ajrit. Ato ne asnje menyre nuk duhet te digjen pasi nga ky process mund te shperndahen ne ajer gaze dhe toksina shume te demshme per shendetin e njeriut. Ndersa ne spitalin e ketij qyteti nuk vihet re nje proces i djegies, kujdes ne kete drejtim duhet te kene qendrat shendetesore te cilat shpesh djegin keto mbetje spitalore,duke ndikuar negativisht ne ndotjen e ajrit dhe mjedisit ne pergjithesi.

Objekti i spitalit rajonal ndodhet ne nje skaj te vecuar dhe eshte larg rrugeve te ketij qyteti,duke bere te mundur mosndotjen e ajrit nga pluhuri i makinave. Gjate levizjes se makinave pluhurat mund te konsiderohen si mundesi per ndotjen e ajrit ,problem ky sidomos gjate stines se thate te veres e kur fryjne erera te thata te cilat ndikojne ne ngritjen e pluhurit.

BAZA LIGJORE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE SPITALORE

Ligji nr. 10431, datë 09. 06. 2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"

Ligji Nr.10463 dt 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve

Ligji nr. 9537, datë 18. 5. 2006 " Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme"

VKM nr.798, datë 29. 09. 2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore"

Ligji nr.9323, datë 25. 11. 2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik"

Ligji nr. 10, datë 11. 05. 2009 "Për shëndetin publik"

VKM nr. 99, datë 18. 02. 2005 "Për aprovimin e katalogut Shqiptar për klasifikimin e mbetjeve"

Pergatiti Raportin e VNM

Afrim Kurtaga

Ing. Remzi PUPLI